



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:246926

Datë: 30.10.2023

Numri i dokumentit: 04844723

PPP.nr.81/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, si gjykatë e shkallës së parë përmbarimore me gjyqtarin Astrit Gashi dhe me bashkëpunëtorin profesional Remzi Duli, në lëndën përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “P...” Sh.A, kundër debitorit A.O nga Komuna Gllogoc për pagimin e borgjit në shumën prej **243.55 €**, duke vendosur në prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhërit për caktimin e përmbarimit të përmbaruesit privat D.G në Prishtinë, P. nr... i datës 14.10.2021 jashtë seancës gjyqësore me datën 27.10.2023 e merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET në tërësi si i bazuar** prapësimi i debitorit A.O nga Komuna e Gllogocit.
- II. REFUZHET në tërësi si i pa bazuar** propozimi i Kompanisë Rajonale të Mbeturinave “P...” Sh.A në Prishtinë, të datës 04.10.2021 sa i përket borgjit/kërkesës në shumën prej **243.55 €**, ashtu që Urdhëri i përmbaruesit privat D.G nga Prishtina, P. nr... i datës 14.10.2021 **SHFUQIZOHET**.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat D.G nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “P...” Sh.A në Prishtinë të datës 04.10.2021 ka caktuar urdhërin për përmbarim P. nr... i datës 14.10.2021 kundër debitorit A.O nga Komuna Gllogoc në bazë të Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste të kontabilitetit ID nr..., me të cilin urdhër është detyruar debitori për shërbimet komunale-bartjen e mbeturinave për periudhën kohore nga data 01.01.2009 deri me datën 31.01.2013, të i paguaj borxhin kreditorit shumën prej 243.55€ me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e lejimit të përmbarimit deri në pagesën definitive nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë me ndalimin e mjeteve monetare nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë e kreditorit nr..., me ndalimin e mjeteve nga të ardhurat personale ose regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme të debitorit deri në vlerën e borxhit.

Debitori ka parashtruar prapësim kundër urdhërit për caktimin e përmbarimit për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave materiale me pretendimin se: Debitori fare nuk është njoftuar me një faturim të borxhit të tillë dhe nuk ka asnjë njohuri për ngarkesën e tillë për shpenzimet e mbeturinave që në këtë periudhë ka banuar në një lagje tjetër dhe nuk ka pranuar asnjë shërbim të kreditorit për pastrimin – bartjen e mbeturinave, dhe as që ka pas kontejner të vendosur në atë periudhë, nuk ka kontratë të nënshkruar me kreditorin, asnjëherë nuk ka pranuar faturë për shërbimet e sipërsënuara të kreditorit dhe se një borxh të tillë nuk e ka krijuar. Kërkesa e kreditorit është parashkruar ngase ka kaluar afati i kësaj kërkesë konform Nenit 71 par. 1, pika 1.4 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore në lidhje me Nenin 360 par.1.1 të LMD-së, nga këto shkaqe i ka propozuar gjykatës që të hedhë poshtë propozimin e kreditorit për përmbarim si të paafatshëm.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, ka kundërshtuar prapësimin me pretendimin: çdo qytetari ju ofrohet shërbimi për ujë, kanalizim dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësisë lokale. Andaj edhe debitorit në fjalë i janë ofruar këto shërbime rregullisht dhe kompania ka kryer shërbimet e bartjes së mbeturinave, për interes të debitorit.

Me nenin 21 të LPP-së parashihet: *organi përmbarues e cakton përkatësisht zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titullin ekzekutiv) dhe dokumentit të besueshëm.*

Me dispozitën e Nenit 29 par. 1 të LPP-së parashihet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit në të kërkesës në të holla caktohet edhe në baze të dokumentit të besueshëm”,* ku, dokument i besueshëm sipas par. 1 pika 1.2 të Nenit 29 të LPP-së janë: *ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave.*

Me Nenin 360 par. 1 pika 1.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (nr. 04/L-077) parashihet se: *“kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të gojaçeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit të njëjtë parashihet: “afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”, kurse në paragrafin 3 të nenit të njëjtë parashihet se “parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.*

Me nenin 368 të LMD-së në par. 1 parashihet se *“parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borgjin”,* ndërsa me par. 2 të nenit të njëjtë parashihet se *“pranimi i borgjit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë sikurse janë: pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.*

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës pretendimeve të debitorit në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit në përgjigje të prapësimin të debitorit, e duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e të drejtës materiale gjykata ka gjetur se prapësimi i debitorit i paraqitur kundër urdhërit të përmbaruesit privat P. nr... i datës 14.10.2021 me të cilin është caktuar përmbarimi i kreditorit për përmbarimin e borxhit ndaj debitorit në shumën prej 243.55 €, **është i bazuar.**

Në bazë të nenit 360 par.1 pika 1.1 të LMD-së, mori aktvendim si në piken I të dispozitivit me të cilën aprovoi prapësimin e debitorit për borxhin në shumën prej 243.55 €, dhe për këtë urdhërin e përmbaruesit privat e shfuqizoi sepse, për **këtë borxh të krijuar për periudhën kohore prej datës 01.01.2009 deri me datën 28.02.2013 ka arritur parashkrimi absolut dhe kreditorit për realizimin e këtij borxhi i ka pushuar e drejta e kërimit të përmbarimit të detyrimit**

nga debitori. Kjo, për faktin se kreditori propozimin për përmbarim tek përmbaruesi privat e ka parashtruar me datën 04.10.2021 që nënkupton se nga data e krijimit të këtij borxhi e deri në parashtrimin e propozimit për përmbarim kanë kaluar më shumë se tetë vite e që rezulton se propozimi për përmbarim te përmbaruesi privat për këtë borxh në shumën prej 243.55 € është parashtruar pas kalimit të afatit ligjor të paraparë me Nenin 360 par .1 pika 1.1 të LMD-së.

Nga e lartë theksuara në bazë të Nenit 73 paragrafi 3 të LPP-së gjykata e merr këtë aktvendim dhe vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
Departamenti i Përgjithshëm, PPP. nr. 81/21 i datës 27.10.2023.

G j y q t a r i

Astrit Gashi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej shtatë (7) ditë nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e përmes kësaj gjykate në tre kopje.

Ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi nuk e ndalon procedurën përmbarimore përveç nëse është paguar garancinë nga debitori në shumën e plotë të borxhit (neni 78 par. 1 dhe 2 të LPP)